

OSO KUKA NË KULLË T'BAROTTIT



BOTIMET
TOENA
TIRANE

CITTA' di CHIERI
CONSIGLIERE COMUNALE
Vincenzo Cucci

ODHISE K. GRILLO

Oso Kuka në kullë të barotit

*Ilustrimet:
Vehap Kokalari*



Kështrimet e dëgjoi e
rënkoj, që
në brez, por
kujtoi atë
trimi nuk
- Ndale atë vrapi, o Avni Pashna e mos e thuan qyjet e
qiell e për këtë dñe e nel te që përfekte te zezen e
djem si zatia, qe kujte sive besa e burri i e lapi i jeti parë
larta e i ngrenë përgjet me armi
kanë lënë të parët amanet. Një
me dyzet trima e po juva vë kuqirin

- Ndale atë vrapi, o Avni Pashna e mos e thuan qyjet e
qiell e për këtë dñe e nel te që përfekte te zezen e
djem si zatia, qe kujte sive besa e burri i e lapi i jeti parë
larta e i ngrenë përgjet me armi
kanë lënë të parët amanet. Një
me dyzet trima e po juva vë kuqirin

BOTIMET TOENA

Tiranë 2000



BIBLIOTECA



Paska dalë Avdi Pasha i Shkodrës në sheshin e pazarit e paska thënë se Shqipëria nuk ka asnje burrë, gjersa s'po nxjerr në Vraninë një trim që të matet me cubat e Malit të Zi, të cilët vrasin e presin djemtë e rinj shqiptarë, grabitin lopët me gjithë viça nëpër vatha e stane, therin dhentë me gjithë ogica, djegin kulla e kasolle dhe plagosin përjetë sa e sa nëna shqiptare.

- Ç'e do, - paska thënë pashai, - kur nuk kam asnje bir në vatër, se kisha për t'ia veshur nënën me të zeza knjazit, kisha për t'ia bërë motrën të qante natë e ditë, kisha për t'ia shuar farën e keqe të cubave.



Kështu tha pashai turkoshak dhe Oso Kuka që sillej atypari e dëgjoi e rënroi, e dëgjoi e u nxi siç nxihet qelli në dimër kur bie e fryn. Pa vuri dorën në brez e kapi alltien dhe deshi ta dërgonte në botën tjetër pashanë, por kujtoi atë plakun e moçëm që paska thënë se i mençuri nuk ngutet kurrë dhe trimi nuk tutet asnjëherë, prandaj e hoqi dorën dhe i tha pashait:

- Ndale atë vrap, o Avdi Pasha e mos e thuaj dy herë atë fjalë, se për atë quell e për këtë dhé, e bëj të qajë përjetë të zezën nënën tënde. Në Shqipëri ka djem si zana, që kur e lyp besa e burräria e japid jetën pa iu dridhur qerpiku, për trojet e veta, për kanun e fe, për vatër e nder. Ata i rrafshojnë kalatë e larta e i ngrenë pirjet me armiq të vrarë si kodra e si male; se kështu ua kanë lënë të parët amanet. Një trim kërkove të dalë në Vraninë? Ja ku po dal me dyzet trima e po jua vë kufirin te thana cubave të knjazit.



Paskardale Avdi Pasha vënëndres, në sheshin e pazarit e

Dhe dha fjalën e burrit e besën e shqiptarit se pa u djegur së gjalli nga flaka e barotit s'do ta lëshonte kurrë Vraninën. Avdi Pasha u çmerit dhe i dha dorën Oso Kukës:
- Aferim, o trim mbi trima, se kuptohesh nga fjala e njihesh nga duka që je burrë e shkuar burrit, që je sokol mbi sokola.



Zgjodhi pikën e djallit Oso Kuka për të dalë në Vraninë, aty ku loket qanin djemtë trima, ku nuset ktheheshin në gjini duke mbajtur duart në kraharor, ku të gjithë e pritnin si dita diellin. Dhe në krye të javës u pa të ngjitej në Qafë të Kalasë tok me dyzet trima...


Një qyqe qan e vajton përmallshëm e si asnjëherë tjetër në atë Vraninën e zezë në breg të lisenit. Mos vallë qan fatin e saj të zi që mbeti pa bir e pa bijë? Nuk po qan për fatin e saj po për motrën e Avdi Hisës që ka mbetur shkretane se i është rrëzuar kulmi i shtëpisë. Se në mrizet e Vraninës paska dalë Vulo mustaqegjati dhe e ka vrarë prapa kraheve e ia ka marrë bagëtinë nga vatha.



Kur pa të vëllanë të shtrirë në vig, e motra ia thirri kujes sa u drodhën malet e fushat pérreth:

- Qyqja motra pér vëllanë, pér atë vëlla që e kisha sa një lis me maja në lulëzim. Kur po mendonim ç'nuse të të gjenim, të sollën të vrarë nga dora mizore e Vulo cubit, që të martoi me tokën tënde të dashur. Pér ty po qan qyqja, e cila do të bredhë anembanë Shqipërisë dhe do të vajtojë.

"Kurre s'kam parë e dëgjuar të mbetet hak pa marrë e gjak pa larë. Po gjaku i Avdisë a do të merret vallë?"



U paniq e kështu qau motra e Avdi Hisës dhe e dëgjoi tërë Shkodra te viarë Vuloja e bëftë që jetë i cili i dëgjoi edhe Oso Kuka dhe aq i vrapit me tata.

Cubat u si i vrapancës simejshen e kështu qau motra e Avdi Hisës që dëgjoi tërë Shkodra e Shqipëria. Pa e dëgjoi edhe Oso Kuka me trimat e vet, prandaj u ngrit e tha:

- Ngrihi djem, he ju vraftë buka e marrshi rrugët e detit po nuk e shpaguam gjakun e Avdisë e po nuk ia kthyem nderin vendit.

- Ngrihi djem, he ju vraftë buka e marrshi rrugët e detit po nuk e shpaguam gjakun e Avdisë e po nuk ia kthyem nderin vendit.



O Zot i madh si janë çuar trimat: ashtu si kanë qëlluar, mbathur e zbathur, veshur e çveshur. I kanë rrëmbyer armët e si përrua i rrëmbyer kanë vërvshuar poshtë fushës aty ku qante motra e Avdisë. Pastaj janë ngjitur përpjetë malit pa iu zënë këmba dhé, sikur të shkonin në dasëm e jo drejt vdekjes. Sytë u nxirrin flakë e shkëndija dhe në breg të Moraçes, pranë Bjellopoljes, krisi pushka e parë e Preng Markolës nga Mirdita. Se ai i pa i pari cubat kur po zbrisnin drejt Ponarit.



I pari hëngri dhé Pavlloviçi, që kishte vënë përpara bagëtinë. Kur pa shokun tē vrarë Vuloja i nisi dhitë drejt bregut dhe mori malin përpjetë. Kaq desh Oso Kuka dhe u lëshua përmbi ta, në krye tē shokëve.

Cubat u shpérndanë si pulat kur bie skifteri mbi to dhe u turrën si lepujt poshtë e përpjetë sa nuk e pa i pari tē mbramin. Po në ia mbathën cubat, Vuloja s'e hodhi hapin më tej, se paskish qenë trim, që i bëfsha gjémën i bëfsha. Drejt tij u nis Kern Zagora, rrufeja e malit. Ai keni parë si ndeshen dy luanë në fushën e shkretë? Ashtu u ndeshën Kerni e Vuloja sa u drodh lugina e qau pylli. I mbuluan djersët, plagët e gjaku. Oso Kuka i pa e u shkoi pranë. Kerni çoi shpatën përpjetë e Vulojangriti sytë. Atë çast Kerni ia nguli thikën në zemër... Oso Kuka shkoi e përqafoi Kernin dhe bashkë me shokët u nis për në Vraninë, ku për tē këndonte Zana e malit, e cila thoshte se qe ku lindi dielli në mëngjes e ku nis hëna tē dalë, nuk lind më nëna tjetër Oso Kukë.

Na ishte Osoja një vigan që matej me divat: kaleshan e sypërgjakur, me mustaqet që i lëvareshin gjer poshtë në brez. Kur fliste ushtonte fusha e kur vikaste dridhej mali. Kur vringëllonte taganin dukej se shkrepte rrufeja. Thoshin se kishte lindur dragua dhe kishte tri zemra e tri palë krahë tē artë për nën sjetulla. Plumbi nuk ngulej në trup tē tij po kthehej prapa e tagani përkulej dhe bëhej drapër. Edhe me top t'i bije shpirti i tij nuk i shqitej nga trupi.



Sa arriti Osoja me shokë në Vraninë u hap lajmi si rrufe. E dëgjoi edhe knjaz Nikolla në Cetinë e mblodhi rreth vetes të parët e komandarët dhe u tha:

- Nuk pyesim për Oso Kukë. Ose i bëjmë toka tonat që nga Rozafati në Krujë e në Deçan, o shuhemi të tërë. Më ka dhënë urdhër Moskovi, që t'i shtrojmë urat se dëshiron të dalë det më det.

Pas tij u ngrit Mirkoja, që ishte i pari ndër të parët dhe tha:

- Unë po zgres me shtatëqind çetinas në Vraninë dhe Gjukoviq Pera me katërqind biocas. Me këto çeta kam uzdajë se, ose do t'i vë kapicën malaziasve mbi krye, ose do t'ia sjell kokën në Cetinë përmbi tepsi.

- Të lumtë goja, o Mirko trimi, - ndërhyri knjazi. - Ju i bini Osos e unë do të ndaj e do të përcaj hajraqet e bajraktarët. Pa do të ndaj e përcaj edhe babën me të birin në Shqipëri. Pa do të lidhem me bullgarë e grekë, siç ka bërë urdhër Moskovi, dhe do ta bëjmë Shqipërinë tonën.



Kështu ra ushtria e knjazit mbi Vraninë me urë në dorë, sa nisën të krrokasin korbat e sorrat qosh më qosh... Kur i pa Oso Kuka me shokë tha:

- Qoftë mallkuar ai bir shqiptari, plak a i ri qoftë, që s'çohet me këmbë, s'rrok armët e s'lidh besën arbërore për të dhënë jetën që Shqipëria të mos bjerë në duart e knjazit e të Moskovit. - Pastaj iu drejtua trimit Kaçel: - Na e këndo atë këngën e Gjergj Elez Alisë, që të na ngrohet gjaku e të na shtohet trimëria.

Dhe Kaçeli mori çiftelinë dhe i këndoi zemra më mirë se çdo herë tjetër. Atëherë u çuan trimat e zbritën në Vraninë ku po hynin cubat e Gjukoviq Perës, të Mirkos e të Zeliq Gjukës. Ky bir bushtre Zeliq Gjuka desh të kalonte lumin tinës që t'u dilte prapa krahëve malësorëve, po pushka e Kern Gilës e la shakull dhe e morën valët tatëpjetë, ndërsa thërriste me të madhe "kuku majka!" Kur panë e dëgjuan Zeliqin të tjerët morën fushat e malet. Po vikati Mirko Serdari dhe u mblohdhën prapë si korbat.



Krujë e në Deçan, o shuhemi të tërë. Me ka shtrojmë ushtari që i
Pa kur ra Oso Kuka me trima mbi ta, aman o Zot, si u
pas tij flakë Vranina. Qielli u nxi, pushka nuk pushoi asnje
çast, tymi e flaka mbuluan dynjanë. Pa u mbush lumi me
koka të prera malaziasish...

Kur pa tërë ata ushtarë të shtrirë pa koka e pa jetë, Mirko
Serdari nxori nga brezi jataganin, që e kishte të ndryshkur
nga gjaku, dhe thirri:
- Të futemi brenda në kullën e barotit, o sokola të Malit
të Zi!



Harroi zogu i shkinës se aty ishte Oso Kuka me trimat e vet, që iu sulën duke bërë gjëmën e duke sjellë vdekjen. Pastaj u futën vetë të parët në kullën e barotit. Sa i panë zanat e malit kënduan e vajtuan:

- Lum si ata burra me Oso Kukën në krye, që do të japid jetën për atdhe. U qoftë e lehtë toka që do t'i mbulojë. U kalofshin motet të butë e të ëmbël si pranvera dhe sa të ketë diell e hënë mos u harrofshin kurrën e kurrës. Gjaku që do të derdhin t'u ndezë zemrat shqiptarëve.



Kur panë malaziasit se s'po ndihej më pushkë, u sulën mbi kullë. Njëqind hipën mbi kullë e njëqind mbi çati, njëqind mbi frengji e njëqind mbi shkallë. Po ka zot shtëpia e dhunuar dhe nga pas të vë gjobën... Prandaj Oso Kuka thirri aq sa e dëgjuan edhe në Shkodër e Cetinë:

- Ah, me ngadalë, o Nikollë, të vraftë Zoti, të vraftë. A e di si më quajnë mua? Ma thonë emrin Oso Baroti. Ti s'ke parë gjer më sot shqiptarë me sy... Po do të shikosh mua që do të djeg veten dhe ty.



Dhe ia vuri zjarrin barotit e kulla u hodh njëmijë pass lart në qiell, Vranina u trand nga themelet, liqeni s'i pushoi valët tri ditë e tri netë, kalaja e Shkodrës u drodh nga gjëmimi. Dhe t'u coptuan e t'u përzien koka e gurë, krahë e trarë, këmbë e tjegulla, trupa e qepra, tymi, flaka e shkëndia. Aty u banë shkrumb e hi katërqind cuba malazias dhe ranë me lavdi tridhjetë shqiptarë me në krye Oso Kukën.

Nëpër deljet e gjithë Shqipërisë



Kur morën vesh gjëmën zanat e malit kënduan:

- Eni, eni në Vraninë, o shqina të mblidhni nëpër sheshe e përrrenj kokat, krahët, këmbët e trupat e djemve tuaj dhe shkrrumbin e hirin në kullën e Vraninës. Dhe i mësoni fëmijët të mos i lakmojnë trojet e kastriotëve se gjaku që derdhi Oso Kuka me trimat e vet vlon e do të vlojë për jetë nëpër dejet e gjithë shqiptarëve!

Kur panë malaziasit se s'po ndihet më pushkë, u sulen mbi kullë. Njëqind hipën mbi kullë e njëqind mbi catt, njëqind mbi frapoll e njëqind mbi shkallë. Po ka zot shtëpia e dhunuar dhe nga pas të vë globën... Prandaj Oso Kuka thirri aq sa e dëgjuan edhe në Shkodër e Cetinë.

- Ah, me ngadalë, o Nikollë, të vrafsh Zoti, të vrafsh. A e di si më quajnë mua? Ma thonë emrin Oso Barotti. Ti s'ke parë gjer më sot shqiptarë me sy... Po do të shikosh mua që do të djeg veten dhe ty.

LEGJENDA SHQIPTARE - 11
libra të ilustruar për fëmijë

**OSO KUKA
NË KULLË TË BAROTIT**

Autor: Odhise Grillo

Piktor: Vehap Kokalari

Përkuqdesja grafike: Irena Toçi

Janë në qarkullim nga e njëjta kolanë:

SKËNDERBEU

BESA E SHQIPTARIT

DY BATOT DHE ZANA E ILIRISË

TRIM MBI TRIMA, GJERGJ ELEZ ALIA!

MARO KONDA, TRIMËRESHË!

PRITE, PRITE AZEM GALICËN!

KAPEDAN ÇELO PICARI

LEGJENDA E NJË SHKËMBI

OSO KUKA NË KULLË T'BAROTIT

KOSTANDINI DHE DHOQINA

ZANAT E MALIT DHE FUQIA E MUJIT

KËSHTJELLA E ROZAFATIT

NËNA ME ZEMËR TË MADHE